



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 408 Prot.

V E N D I M

NR. 24 , datë 08.04.2020

MIRATIMI I KRITEREVE PËR DY VENDE TË LIRA PUNE NË POZICIONIN "ROJE"  
NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE, PRANË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE  
UNIVERSITARE

Në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë" neni 49, si dhe bazuar në shkresën e Administratorit me Nr. 404 prot .. datë 06.04.2020, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 08.04.2020,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret dhe shpalljen e konkursit në faqen zyrtare të Universitetit për dy vende të lira pune në pozicionin "Roje" në Sektorin e Shërbimeve, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Universitare.

**A. Të interesuarit për pozicionin e mësipërm duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë kryer arsimin e mesëm;
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
4. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
5. Të ketë përvojë pune.

**B. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët që konkurojnë :**

1. Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
  2. Curriculum Vitae;
  3. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
  4. Çertifikatë e përbërjes familjare;
  5. Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
  6. Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
  7. Fotokopje e librezës së punës;
  8. Motivacioni i largimit nga puna e fundit (nëse është i punësuar / ka qenë i punësuar);
  9. Raport mjeko-ligjor;
  10. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
  11. Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Dr. Merita ISARAJ

